

Firmoset Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)



Firmoset Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), për të përmbushur angazhimet në kuadër të Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021". Qëllimi i kësaj Marrëveshje është dhënia e bursave dhe përcaktimi i kriterëve për përfitimin e tyre sipas programeve të studimit. Kjo marrëveshje parashikon kriteret shtesë dhe fushat prioritare për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare që do të aplikojnë për përfitimin e 9 bursave të studimit nga Republika e Shqipërisë për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare nga Ukraina, komuniteti Arbëresh në Itali, Kroacia dhe Bullgaria për vitin akademik 2020-2021.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

Ukrainë, Finlandë, Austri, mbërrijnë tekstet dërguar nga Qendra e Botimeve për Diasporën




Ukrainë, Finlandë, Austri, janë dërguar falas tekste shkollore dhe plotësuese të paracaktuara për mësimdhënien e gjuhës dhe kulturës shqiptare nga Qendra e Botimeve për Diasporën, të cilat arrijnë tashmë te mësuesit e shkollave shqipe atje, pikërisht në kohën e duhur për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021. Librat, të dërguar nga QBD-ja, nën kujdesin e veçantë të Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe të mbërritur përmes MEPJ-së e Postës Shqiptare. Tekste të ndryshme shkollore, tekste cilësore që kanë shenjuar letërsinë shqipe, seria më e re e botimeve dygjuhëshe nga Qendra e Botimeve për Diasporën, një sërë vlerash, materiale të ndryshme didaktike, akses online të botimeve tona dhe të platformës së mësimi shqip "Schoolme" janë tashmë në dispozicion të mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë.

"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

QBD sjell në një botim shqip – greqisht "Rosaku i Shëmtuar" dhe "Kësulëkuqja"



Ndër 2623 tekste mësimore të dërguara rishtas në të gjitha shkollat e gjuhës e kulturës shqiptare në Greqi për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021 do të jenë dhe botimet dygjuhëshe të Qendrës së Botimeve për Diasporën. "Rosaku i shëmtuar" dhe "Kësulëkuqja", dy nga përrallat më të dashura për fëmijët, pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh" - projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe greqisht. Libri i sjellë në shqip nga Parid Teferiçi dhe në greqisht nga Maklena Nika, i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme në dy gjuhë që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese. "Rosaku i shëmtuar" dhe "Kësulëkuqja", shqip dhe greqisht vjen falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

Greqi / Mësuesit e gjuhës shqipe marrin tekstet mësimore dërguar falas nga QBD



Greqi 2623 tekste shkollore dhe plotësuese për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në Diasporë arrijnë te mësuesit e shkollave shqipe në Greqi. Megjithatë situatën e vështirë në të cilën ndodhemi për shkak të pandemisë, Qendra e Botimeve për Diasporën arriti t'i dërgonte në kohë tekstet shkollore dhe plotësuese për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021. Me mbështetjen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe nën kujdesin e veçantë të Ministrisë së Shtetit për Diasporën, tekstet kanë mbërritur në Ambasadën e Shqipërisë në Greqi dhe i janë dorëzuar mësueses së nderuar të kursit të gjuhës shqipe në zonën e Renti-Pire, znj. Lefteri Metkaj. Qendra e Botimeve për Diasporën vuri në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve për herë të parë këtë vit serinë e re të botimeve dygjuhëshe. Tekstet shkollore dhe plotësuese për mësimin gjuhë dhe kulturës shqiptare kanë mbërritur edhe në ambasadat tona në Belgjikë, Ukrainë, Francë, Suedi, Finlandë, Zvicër, Sllovakia dhe Austri.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

KKD / Mark Gjonaj ka drejtuar seancën dëgjimore të Këshillit të qytetit me bizneset e vogla



Z. Mark Gjonaj, kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së New York-ut, ka drejtuar seancën dëgjimore të Këshillit të qytetit me bizneset e vogla. Në kuadër të fushatës së tij "Save Small Businesses", diskutimi kishte në fokus gjendjen e bizneseve të vogla të komunitetit dhe dhënien e zgjidhjeve për sfidat e tyre për shkak të Covid-19. Z. Gjonaj, së fundmi i është gjetur pranë dhe fëmijëve shqiptarë në Mal të Zi me dhurimin e materialeve shkollore dhe maskave në prag të fillimit të vitit të ri shkollor.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).